

NDËRMARRJA „RANORI

SH.P.K. Adresa: Rr. Ilaz Kodra,

3/5 Komuna SKENDERAJ

RAPORT


I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR HULUMTIMIN,
EKSPLOATIMIN, THËRMIMIN DHE
SEPERIMIN E RËRËS KUARCORE
NË LOKALITETIN KLLODERNICË,
KOMUNA SKENDERAJ

Nentor, 2024

Ndërmarrja „Ranori” Sh.P.K. Skenderaj, për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për hulumtimin, eksploatimin, themimin dhe seperimin e rërës kuarcore në lokalitetin Kllodernicë, Komuna e Skenderajit, autorizon Prof.Dr. Islam Fejza, person fizik për hartimin e Raporteve të VNM-së :

Investitori: Ndërmarrja „Ranori” Sh.P.K.

Drejtor menaxhues: Fatmir Imeri



Hartues i Raportit të VNM-së:

Prof.Dr. Islam Fejza, Person fizik i Licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së,
Licenca nr. 5/19

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to Prof. Dr. Islam Fejza, is written in a cursive style.

Përmbajtja

1. 0 Hyrje	5
2.0 Baza ligjore për hartimin e raportit të VNM-së	6
2.1 Rregullativa ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës	8
3. 0 Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit	9
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit	9
3.2. Popullata dhe Vendbanimet	14
3.3. Lidhjet e Komunikacionit	15
3.4. Kushtet klimatike	15
3.5. Relievi	16
3.6. Hidrologjia	16
3.7. Pedologjia.....	16
3.8. Ndërtimi gjeologjik lokacionit.....	17
3.9. Natyra dhe biodiversiteti	19
3.10. Bimësia dhe vegjetacioni	19
3.11. Bota shtazore – Fauna	19
3.12. Peizazhi	19
3.12. Ajri.....	20
3.13. Uji	20
4.0 Përshkrimi i procesit të hulumtimit, eksploatimit, thermimit dhe seperimit	20
4.1 Gjate fazes se Hulumtimit	20
4.2 Gjate fazes se Eksploatimit	20
4.2.1 Përshkrimi i procesit të shfrytëzimit	21
4.3 Përshkrimi i procesit teknologjik te thërmueses me seperacion dhe pajimeve përcjellëse	22
5.0 Vlerësimi dhe Përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	26
5.1. Ndikimet në ajër	26
5.2. Ndikimet në tokë	27
5.3. Ndikimet në ujë	27
5.4. Ndikimet në Peizazh	28
5.5. Ndikimi në florë dhe faunë	28
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	29
5.7. Zhurma	29
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	30

6.0 Marrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve	30
6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit	30
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës	32
6.3. Masat për mbrojtjen e ujit	33
6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma	35
6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore	36
6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet e aksidenteve mjedisore	36
7.0 Programi i monitorimit	37
8.0 Raportimi	38
9.0 Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të aktiviteteve punuese	39
9.1. Objektivat e rikultivimit	39
10.0 Kontrolli i emisioneve pas shfrytëzimit dhe thërrmimit me seperim	44
11.0 Konsultimi me publikun	44
11.0 Kostoja e parashikuar e Investimeve	45
12.0 P Ë R F U N D I M E.....	46

1.0 Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hulumtimin, shfrytëzimin, themimin dhe seperimin e rërës kuarcore në lokalitetin Klodernicë, Z.K Klodernicë me nr. te parcelave: P-72015031-00401-0, P-72015031-00402-0, P-72015031-00403-0, P-72015031-00404-0, P-72015031-00405-0, P-72015031-00407-0 dhe P-72015031-00408-0 ne vendin e quajtur Peshkenicë dhe Reshkanicë, Komuna e Skenderajit, është punuar në bazë të kërkesës së Fatmir Imeri, Drejtor menaxhues i Kompanisë “Ranori” Sh.P.K.

Raporti në fjalë paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor e pastaj lejeve tjera të nevojshme për hulumtimin, shfrytëzimin dhe seperimin e reres kuarcore me qëllim që të analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë, duke i parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të kryhen këto aktivitete.

Qëllimi i projektit: analizimi i karakteristikave të gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin ku do të kryhen aktivitetet për hulumtim, eksploatimin dhe seperim të reres kuarcore, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinierike- teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër.

Gjyatë hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të përkufizohen të gjitha ndikimet relelevante që mund të paraqiten në relacionin: hulumtim, eksploatim dhe seperim të reres kuarcore me aktivitetet tjera minerare dhe mjedisin. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t`u ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së përgatitjes së fushës për fillimin e punëve për hulumtim, eksploatimin dhe seperim të reres kuarcore, gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik për eksploatimin dhe seperimin e

zhavorrit dhe reres kuarcore me aktivitetet tjera minerare, dhe pas përfundimit të projektit në lokalitetin Kllodernicë , komuna e Skenderajit.

2.0 Baza ligjore për hartimin e raportit të VNM-së

Raporti i VNM-së përfshinë identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjatë realizimit të punimeve për hulumtim, shfrytëzim dhe seperim të reres kuarcore bazuar në :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjerë në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM-së, është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së .

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative, të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private, garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.

Ligjet me të rëndësishme të aplikuara për hartimin raportit të VNM-së për këtë qëllim janë si më poshtë:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes Nr .03 / L-043
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji për Energjinë Nr. 05/L- 081
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110

- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina nr.08/L-071 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit me Nr. 04/L-060
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës nr. 03/L-153
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqorë.
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palevizshme të ndotjes.

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë, për nevojat e hartimit të raportit të VNM-së, janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis siç është direktiva 2014/52/EU e PE dhe Këshilli e dt.16 Prill 2014 e cila ndryshon Direktiven 2011/92/EU mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private b) dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe me ekspertët që do të udhëheqin procesin e

hulumtimit, shfrytëzimit dhe seperimit të reres kuarcore si dhe vizitave të bëra në terren, janë shfrytëzuar edhe:

- Elaborati gjeologjik për vendburimin e lartcekur
- Projekti kryesor për shfrytëzimin e gëlqerorëve të mermerizuar
- Çertifikata e biznesit
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopjet e planit të ngastrave
- Plani i situacionit
- Kontrata për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm të ngastrave kadastrale
- Pëlqimin nga komuna e Skenderajit

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për hulumtimin, eksploatimin dhe seperimin e reres kuarcore, bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë :

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut , topografia dhe peizazhi
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin Kllodernicë, komuna e Skenderajit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimi të gjendjes ekzistuese.

3.0 Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni i planifikuar për hulumtimin, eksploatimin dhe seperimin e reres kuarcore gjendet në perendim te qytezes se Runikut në rajonin e fshatit Kllodernicë. Kufizohet me Vragodolin ne jug, Izbicën në jugperendim, Leçinën në veri perëndim, Tërnoven ne veri, Kllodernicën dhe Këstercin në verilindje dhe Runikun në Lindje.

Në aspektin administrativ i takon Komunës së Skenderajit.


Komuna e Skenderajit zë vend qendror në Drenicë, shtrihet në një sipërfaqe prej 378 km². Në veri kufizohet me Komunën e Mitrovicës, në lindje me Vushtrinë, në jugperëndim me Drenasin dhe Klinën, ndërsa në përendem me Istogun. Nëpër Komunë kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike të cilat e lidhin me qendrat e tjera të Kosovës. Komuna e Skenderajt si pozicion gjeografik gjendet në qendër të Kosovës, 50 km në veriperëndim të kryeqytetit të Kosovës Prishtinës. Skenderaj si komunë është i përshirë në regjionin e Mitrovicës dhe është 20 km në juglindje të këtij qyteti.

Kompania “Ranori”SH.P.K, hulumtimin, eksploatimin dhe thermimin - seperimin e reres kuarcore mendon t'i shfrytëzoj në pjesën e ngastrave kadastrale P-72015031-00401-0 – toke bujqesore, kullose e kl.4, P-72015031-00402-0, toke bujqesore are e kl 5, P-72015031-00403-0, toke pyjore mal i kl 3, P-72015031-00404-0, toke bujqesore kullose kl 4, P-72015031-00405-0, toke pyjore mal kl 3, P-72015031-00407-0, toke pyjore mal kl 3, dhe P-72015031-00408-0, toke bujqesore are e kl 5 ne vendin e quajtur Peshkenicë dhe Reshkenicë, Z.K Kllodernicë, Komuna e Skenderajit të evidentuar në Çertifikatën e pronesisë me nr. te lendes: 29757/24, date 28.06.2024, ne emër të Fidaim Imeri – qirambajtje per 99 vjetë. Fidaim Imeri autorizon Kompanine “Ranori” Sh.P.K me perfaqesues Fatmir Imeri qe prane te gjitha Institucioneve dhe subjekteve tjera juridike e fizike ne Republiken e Kosoves te kryej te gjitha procedurat e nevojshme qe kane te bejne me kryerjen e hulumtimeve ne zonen me ngastrat e larte cekura, Autorizimi i vertetuar te Noteri me LRP.nr. 7641/2024, date 03.07.2024. Po ashtu per eksploatimin dhe seperimin e zhavorit dhe reres kuarcore ne ngastrat kadastrale 402-0 dhe 407-0 Fidaim Imeri ka lidhe Kontrate te veçantë te Noteri me

Kompaninë “Ranori” Sh.P.K. Kontrata LRP. Nr. 121/2024 me nr.Ref 121/2024, date 03.07.2024.

Lokacioni gjendet në anën e majtë të rrugës regjionale Skenderaj – Runik - Istog. Në Runik ndahet rruga që të dërgon në lokalitetin ku do të bëhet hulumtimi, shfrytëzimi dhe Thermimi- seperimi i reres kuarcore. Kjo rrugë është e asfaltuar deri te vendi ku mendohet të kryhen keto aktivitete. Në këtë lokacion në afërsi të drejtpërdrejt nuk ekzistojnë objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta gjenden në largësi mbi 250m.

Lokacioni ku mendohet të kryhet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i ketyre inerteve shihet ne pjesën e hartës topografike të më poshtme.



**Harta topografike e rajonit përreth zonës ku do të kryhet hulumtimi, eksploatimi dhe
seperimi i reres kuarcore.**

Koordinata e fushes per hulumtim:

Nr	Y	X		Y	X
1	7473563.783	4733727.75	61	7473296.312	4734682.06
2	7473579.893	4733690.27	62	7473234.471	4734682.44
3	7473580.963	4733667.69	63	7473218.761	4734686.36
4	7473582.432	4733613.48	64	7473194.761	4734698.74
5	7473579.871	4733555.71	65	7473182.611	4734708.42
6	7473579.711	4733550.56	66	7473162.581	4734738.48
7	7473577.45	4733488.48	67	7473148.251	4734754.94
8	7473575.43	4733447.3	68	7473122.771	4734778.18
9	7473606.381	4733482.31	69	7473106.12	4734795.01
10	7473625.912	4733517.72	70	7473077.334	4734821.53
11	7473640.892	4733562.89	71	7473045.66	4734843.5
12	7473650.333	4733603.87	72	7473058.25	4734823.04
13	7473658.814	4733623.9	73	7473060.01	4734813.66
14	7473668.374	4733647.19	74	7473058.529	4734782.02
15	7473674.944	4733650.48	75	7473032.438	4734716.69
16	7473750.686	4733653.29	76	7473027.848	4734686.39
17	7473803.586	4733626.99	77	7473030.687	4734664.11
18	7473818.696	4733626.36	78	7473024.367	4734624.04
19	7473886.518	4733697.04	79	7473015.986	4734582.81
20	7473935.41	4733722.81	80	7473009.356	4734565.59
21	7473957.18	4733722.92	81	7473008.726	4734552.3
22	7473951.08	4733740.99	82	7473036.535	4734511.46
23	7473957.62	4733744.82	83	7473075.416	4734506.18
24	7473988.851	4733747.94	84	7473093.556	4734499.47
25	7474023.242	4733776.74	85	7473107.316	4734498.4
26	7474032.972	4733797.15	86	7473151.207	4734514.17
27	7474049.933	4733862.47	87	7473292.46	4734563.11
28	7474044.223	4733868.75	88	7473307.551	4734561.79
29	7474047.884	4733879.39	89	7473315.691	4734560.52
30	7474041.163	4733881.81	90	7473385.182	4734538.47
31	7474044.754	4733892.8	91	7473409.892	4734527.19
32	7474052.334	4733896.26	92	7473435.902	4734507.05
33	7474023.504	4733934.59	93	7473445.602	4734499.51
34	7474026.044	4733963.44	94	7473473.082	4734471.88
35	7473988.795	4734023.12	95	7473485.462	4734418.73
36	7474006.006	4734098.96	96	7473494.991	4734418.62
37	7473997.476	4734132.76	97	7473525.671	4734395.6
38	7473997.127	4734214.93	98	7473552.321	4734354.02
39	7473961.597	4734257.14	99	7473568.46	4734293.09
40	7473941.347	4734280.75	100	7473590.54	4734217.89

41	7473894.697	4734283.9	101	7473589.579	4734165.68
42	7473803.375	4734293.34	102	7473576.789	4734123.19
43	7473757.805	4734301.36	103	7473561.998	4734080.54
44	7473728.745	4734344.9	104	7473540.637	4734058.09
45	7473722.075	4734358.18	105	7473533.577	4734030.13
46	7473692.325	4734396.81	106	7473499.556	4734018.22
47	7473634.525	4734463.31	107	7473465.265	4733983.54
48	7473600.655	4734502.93	108	7473424.054	4733956.64
49	7473598.225	4734509.9	109	7473400.533	4733932.12
50	7473568.525	4734536.34	110	7473402.273	4733892.2
51	7473496.484	4734594.63	111	7473402.323	4733881.75
52	7473475.534	4734608.9	112	7473409.043	4733850.75
53	7473466.964	4734615.85	113	7473457.853	4733807.05
54	7473445.584	4734629.96	114	7473493.113	4733769.52
55	7473389.523	4734668.41	115	7473500.253	4733739.11
56	7473361.013	4734684.39	116	7473521.353	4733729.84
57	7473336.326	4734685.2			
58	7473319.888	4734677.68			
59	7473311.962	4734674.06			
60	7473305.422	4734679.34			

$$S = 441407.32 \text{ m}^2$$

Koordinatat e fushes per Eksplotim:

Nr	Y	X
1	7473893.65	4733799.176
2	7473800.031	4733757.468
3	7473862.035	4733671.526
4	7473886.518	4733697.039
5	7473935.41	4733722.807
6	7473957.18	4733729.916
7	7473951.08	4733740.986
8	7473893.65	4733799.176

Koordinatat e fushes per thermim - seperim:

Nr	Y	X
1	7473872.61	4733845.505
2	7473896.53	4733801.986
3	7473957.62	4733744.816
4	7473988.85	4733747.935
5	7473999.41	4733757.784
6	7474023.24	4733776.743
7	7474032.97	4733797.152
8	7474049.93	4733862.469
9	7474044.22	4733868.749
10	7474047.88	4733879.389
11	7474041.16	4733881.809
12	7473973.29	4733883.321
13	7473936.05	4733875.942
14	7473872.61	4733845.505

3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorët që jetojnë dhe hapësirën e analizuar. Në Komunën e Skenderajt banojnë mbi 72 mijë banorë ku 99% janë shqiptarë. Në strukturën e popullsisë kryesisht dominon moshja e re dhe atë: 47 % deri në moshën 20 vjeçare, 48 % nga 20-60 vjeç, ndërsa vetëm 5 % të moshuar mbi 60 vjeç. Shtimi natyrorë ka një shkallë të lartë, mbi 28 promilë me një shkallë të ulët të vdekshmërisë rreth 5 promilë.

Në afërsi të lokacionit ku do të behet hulumtimi, shfrytëzohen dhe seperimi i reres kuarcore në mënyrë të drejtpërdrejt nuk atakohen objekte të banimit (shtëpi banimi). Objektet e banimit me popullatë janë larg lokacionit ku do të zhvillohen keto aktivitete minerare.

Duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit, largësinë mbi 250m nga objektet e banimit, zhvillimi i aktiviteteve minerare nuk do të kenë ndonjë ndikim negativ relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen për kryerjen e aktiviteteve minerare. Popullsia e rajonit

merret kryesisht me bujqësi e blegtori. Hapja e një gurore për shfrytëzim dhe seperim në këtë lokalitet do të ndihmonte në zhvillimin ekonomik të rajonit.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ku do të bëhet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore ka lidhje të mira me rrugët rajonale. Përmes rrugës regjionale të asfaltuar Skenderaj – Runik – Istog e lidh vendburimin me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës. Nga kjo mund të përfundojmë se lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni, me të cilën rritet vlera nga aspekti ekonomik, me qëllim të plasmanit të produkteve prodhuese si dhe për furnizim me repromaterial dhe derivate të naftës.

3.4. Kushtet klimatike

Në komunën e Skenderajt si mikroklimë mbizotëron klima kontinentale me verëra të nxehta dhe me dimra shumë të ashpër dhe të ftohtë. Megjithatë komuna ka një terren kodrinor - malor me siguri ka edhe mikroklima të caktuara në pjesë të caktuara të territorit të saj, por në mungesë të një stacioni meteorologjik nuk ka të dhëna të sakta. Të dhënat për kushtet klimatike të komunës merren nga stacioni meteorologjik i Mitrovicës. Temperatura mesatare vjetore është 10°C . Muaji me i nxehtë është Korriku dhe Gushti me 20.4°C . Muaji me i ftohtë është Janari me -1.34°C . Maksimumi absolut arrihet në Gusht me mbi 36.4°C . Minimumi absolut arrihet në shkurt -25.24°C .

Regjimi i reshjeve në komunën e Skenderajt gjatë vitit të reshurat mesatare janë $604,8\text{ mm}$; Vjetorja maksimale 850.9 mm (të reshura). Vjetorja minimale 394.9 mm (të reshura). Ditët më të hershme 5.11. Ditët më të vonshme 3.05. Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 71.4%. Lagështia relative mesatare sipas stinëve në verë është 62.5 %, në pranverë 68.5 %, në vjeshtë 72.6 % dhe në dimër 81.6 %. Erërat dominante në komunën e Skenderajt kanë drejtimin e veriperëndimit. Erërat verore dhe pranverore fryjnë nga jugu. Shpejtësitë mesatare më të mëdha të erërave janë: perëndimore 9.3 m/sec ; verilindore 4.2 m/sec ; veriperëndimore 3.8 m/sec ; jugore 2.8 m/sec dhe lindore 1.6 m/sec .

3.5. Relievi

Rajoni i lokacionit ku planifikohet të kryhet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore karakterizohet me një reliev kodrinor - malor, me pjerrtësi të butë, me lartësi mbidetare rreth 660m.

Relievi me larësit, pjerrtësitë dhe ultësirat e ndryshme ndikon në formimin dhe ndërtimin e elementeve klimatike, në shfaqjen e të reshurave klimatike dhe formimin e rrjetit ujqor të cilat drenohen në prrockat përreth.

3.6. Hidrologjia

Në lindje të komunës së Skenderajt rrjedh lumi Klina, rrjedha e majtë e Drinit të Bardhë. Lumi "Klina" buron në fshatin Kuqicë dhe përshkon territorin në aksin veri - jug dhe kalon nëpër tërë territorin e Komunës si dhe në qendrën e qytetit të Skenderajt me një rrjedhë të ngadalshme, me një thellësi mesatare dhe një gjatësi prej 40 km. Gjithashtu, nëpër territorin e komunës ka edhe një numër të madh përroskash të cilat në tërësi derdhen në lumin "Klina". Rrjedhat e lumenjve nuk i rrezikojnë vendbanimet sepse ato deri më tani nuk kanë dalur nga shtrati i tyre. Në territorin e Komunës së Skenderajt nuk ekziston asnjë liqe, as natyrorë por as edhe artificial përpos disa rezervateve të ujit të cilët edhe ata janë në numër të vogël.

Në afërsi të lokacionit ku do bëhet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore nuk ka rrjedha të lumit, ne jug te zones kalon perrocka e Çerkinit. Gjithashtu shihet qartë se burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat drenohen në kanalet natyrale (prrockat).

Proceset teknologjike gjatë hulumtimit, eksploatimit dhe seperimit te reres kuarcore nuk do të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore pasi që investitori duhet të ndërtoj sedimentuesit për trajtimin e ujërave të ndotura.

3.7. Pedologjia

Lokacioni në të cilën do të bëhet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore, pjesa dërmuese e ngastrave është e mbuluar me shkurre, si dhe bar të

mbirë vet, e cila për shkak të konfiguracionit të saj gjegjësisht pjerrtësisë nuk është e përshtatshme për kultura bujqësore.

Kurse pjesët nga të cilat kemi një proces të alterimit të shkëmbinjve kemi toka që shumë pak shfrytëzohen si tokë bujqësore, por ma tepër janë livadhore me vegjetacion të shumë të dobët të shkurreve dhe gjysmë shkurreve.

3.8. Ndërtimi gjeologjik lokacionit


Në terrenin e hulumtuar shkëmbinjtë më të vjetër janë të moshës së Terciarit (Miocen i mesem – siperm) dhe Kuaternarit (Pleistocen dhe Holocen). Kurse në aspektin regjional terreni përreth është i ndërtuar nga shkëmbinjtë e Paleozoikut ku bëjë pjesë filitet dhe rreshpet kuarc-sercitike, ndërsa pjesa e sipërme rreshpe argjilore - filite, gelqerorë të mermerizuar, ranorë dhe konglomerate kuarcore. Sendimentet Triasike të cilat janë të përfaqsuara nga rreshpe dhe gelqerorë.

Në formë diskordante mbi sendimentet Paleozoike shtrihen sendimentet e kretakut të sipërm, të përfaqësuar nga konglomerate bazale, gelqerorë, dhe ranor flishor. Në terciar, në një pjesë të gjërë të këtij terreni ka ardhur deri te aktiviteti vullkanik. Megjithatë në rajonin e gjerë të terrenit, aktiviteti vullkanik paraqitet në një masë të vogël dhe të izoluar, që vërehet me prezencën e kuarclatiteve dhe tufiteve në lokalitetin e Crepulës.

Pra, siç është sqaruar në përshkrimin gjeologjik në rajonin e hartografuar mund të dallohen këto formacione gjeologjike.

Terciari: -sedimentet e terciarit në kuadër të rajonit të gjërë zënë sipërfaqe të konsiderueshme. Nga të dhënat e gjerëtanishme sedimentet e neogjenit përfaqësohen nga Mioceni (Miocen i mesem – siperm) i përfaqësuar nga sedimente glaciale si: zhavorri, rera, argjila, mergele dhe gelqerore mergelor.

Kuaternari – sedimentet e Kuaternarit shtrihen mbi ato neogjenike dhe përfaqësohen nga Pleistoceni (depozitime glaciale – rere dhe zhavorr) dhe Holoceni nga depozitime aluviale përgjat rrjedhave lumore (rera, zhavorr, argjila).



Harta gjeologjike e lokacionit

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se kjo hapësirë është ndonjë hapësirë e mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është potencial të futet nën mbrojtje.

3.10. Bimësia dhe vegjetacioni

Pjesa e ngastrës ku do të kryhet hulumtimi, eksplotimi dhe seperimi i zhavorrit dhe reres kuarcore është e mbuluar me bar të mbirë vet, manaferra e shkurre. Në bazë të shqyrtimeve vizuale në afërsi të zonës kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, etj.

3.11. Bota shtazore – Fauna

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe në bazë të të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpira, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë - minjtë, prej zvarranikëve - gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat, shqiponja, lakuriqi, etj. Në këtë territor nuk ekzistojnë familje të botës shtazore të ralla që janë nën mbrojtje për shkak të zhdukjes së tyre.

3.12. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin aktiviteti minerar – mjedisi.

Me këtë rast gjithësesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Pamja e këtij regjioni është me pamje kodrinoro-malore.

3.12. Ajri

Edhe pse në rrethinë të këtij lokacioni deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku planifikohet të behet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore. Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe mos ekzistimi i aktiviteteve industriale në rrethinë, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm. Ndotja e pjesërishme e ajrit vjen nga prezenca e madhe e automjeteve në trafik, nga mekanizmi të cilat përdorën për kryerjen e aktiviteteve bujqësore etj.

3.13. Uji

Në këto pjesë të ngastrave ku është planifikuar të behet hulumtimi, eksploatimi dhe seperimi i reres kuarcore nuk kemi ndonjë ujërrjedhë sipërfaqësore, ne pjesen e poshtme të zones kalon perrocka Çerkini me pruarje periodike të ujit vetëm gjatë reshjeve atmosferike. Ujërat sipërfaqësorë paraqiten gjatë të reshurave atmosferike, mund të konkludojmë se kualiteti i ujit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm.

40. Përshkrimi i procesit të hulumtimit, eksploatimit, thermimit dhe seperimit

4.1 Gjatë fazes së Hulumtimit

Gjatë fazes së kryerjeve të hulumtimeve gjeologjike, Kompania "Ranori" Sh.P.K do kryej disa aktivitete minerare, kryesisht përmes hapjes së kanaleve dhe ekzekutimit të disa shpimeve në thellesi deri në 20m për të verifikuar zonën me perspektive për shfrytëzim dhe seperim. Pasi të kryhen këto hulumtime dhe të përcaktohet zona ekonomike për shfrytëzim dhe seperim, Kompania obligohet ta kthejë gjendjen fillestare të ngastrave duke bërë përmirësimin e ngastrave të degraduara dhe kthimin në gjendje fillestare të tyre.

4.2 Gjatë fazes së Eksploatimit

Gjatë fazes së eksploatimit të reres kuarcore nuk do të përdoret metoda e minimit me lëndë plasëse, por do të përdoret metoda e germimit përmes eskovatoreve, kështu që ndotja e ajrit dhe rrezikimi i banorëve përreth do të jete minimal.

Për të shfrytëzuar rërën kuarcoren duhet të kryhen këto procese teknologjike: duhet bërë largimin e shtresës së dheut (sterilit), mihja, ngarkim dhe transporti. Për realizimin e procesit teknologjik për shfrytëzimin e zhavorrit dhe rërës kuarcore nevojiten këto pajime: një eskavator, një bulduzher, një lugë ngarkuese dhe një kamion për bartjen e zhavorrit dhe rërës kuarcore deri te separacioni.

4.2.1 Përshkrimi i procesit të shfrytëzimit

Për të shfrytëzuar rërën kuarcore duhet të zhvillohen këto procese: largimi i shtresës së dheut, mihja dhe ngarkimi i rërës kuarcore, dhe transportimi i rërës kuarcore. Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë .

Mënjanimi ose largimi i shtresës së dheut gjerë sa të arrijmë në shtresën e rërës kuarcore, shtresa e dheut është e ndryshme dhe atë prej 35-50cm. Largimi i shtresës së dheut bëhet me eskavator duke e larguar në një vend të caktuar që nevojitet për deponimin e dheut që do të nevojitet për mbushjen e sipërfaqes së sipërme nga ku është eksploatuar zhavorri dhe rëra kuarcore. Dheu duhet të largohet dhe deponohet në atë distancë e cila e bën të mundur shfrytëzimin pa pengesë të zhavorrit dhe rërës kuarcore, duhet pasur kujdes që gjatë largimit të dheut të mos përzihet me zhavorr, rërë kuarcore apo me material tjetër. Deponia e dheut duhet të caktohet në sipërfaqen e ngastrës që është në mes të hapësirës operuese dhe objekteve banuese, në mënyrë që të pengohet pamja (shikueshmëria) në hapësirat operuese si dhe të bëhet zvogëlimi i nivelit të zhurmës.

Punimet e shfrytëzimit të rërës kuarcore në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim. Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e rërës kuarcore në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:

- lartësia e shkallëve 5m.
- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.
- pjerrtësia punuese e shkallës është 70 gradë.
- shfrytëzimi i rërës kuarcore do të kryhet përmes 4 shkallëve.

- sterili dhe materiali humusor nëpër rrugë të projektuara do të bartët dhe deponohet ne deponinë e caktuar enkas për të e pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.
- karakteristikat hidrogjeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferike me punime minerare lehtë largohen nga karriera
- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit.

Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë.

Etazhet zhvillohen në drejtim lindje - perendim, dhe atë në një kat bëhet përgatitja e fushës për shfrytëzim, kurse në katin (etazhin) më lart bëhet mihja, ngarkimi dhe transporti i zhavorrit dhe rërës kuarcore.

Transporti i zhavorrit dhe rërës kuarcore behet ne kete menyre: gjatë gërmimit rëra kuarcore drejtpërdrejt me eskavator ngarkohet në kamion transportues, ose me eskavator vetëm gërmohet e pastaj me lopatë ngarkuese ngarkohet në kamion transportues për t'u transportuar gjerë në deponinë e seperacionit apo drejtpërdrejt në silosin e seperacionit.

4.3 Përshkrimi i procesit teknologjik te thërmueses me seperacion dhe pajimeve përcjellëse

Materiali i germuar bartet me kamiona dhe deponohet ne vendin e parapare per deponimin e lendes se pare.

1. Nga deponia e lendes se pare, materiali mirret me ndihmen e luges ngarkuese OK 35 dhe vendoset ne dozerin primar me kapacitet 8 m^3 .
2. Nga dozeri me ndihmen e dhanesit i cili eshte i montuar nen dozer materili dozohet ne shiritin(traken) nr 1,
3. Shiriti nr 1 e barte materialin e perzier deri ne seperacionin primar me larje
4. Ne seperacionin primar behet larja dhe ndarja e 3 fraksioneve te materialit,
 - a. Fraksioni 0-4 mm bie ne fund dhe dergohet ne laresin me spirale
 - b. Fraksioni 4-40 mm bie ne shiritin nr 2 e cila eshte e vendosur nen gurethyes me nofull
 - c. Fraksioni i siperm me dimensione $> 40 \text{ mm}$ bie ne gurethyesin me nofull dhe pas thyerjes ne shiritin nr 2
5. Fraksioni 0-4 mm nga laresja me spirale bie ne shiritin nr 3 me te cilen transportohet deri ne shiritin nr 2
6. Fraksionin e perzier i cili vie nga nga seperacioni primar,gurethyesi me nofull dhe laresja me spirale shiriti nr 2 e barte deri ne seperacionin sekondar

7. Ne Seperacionin sekondar behet perseri larja dhe ndarja e 5 fraksioneve te materialit
8. Fraksioni 0-4 mm dergohet ne laresen me korpa dhe nga ajo permes shiritit nr 4 ne deponi
9. Fraksioni 4-8 mm me ndihmen e shiritit nr 5 dergohet ne deponi
10. Fraksioni 8-16 mm me ndihmen e shiritit nr 6 dergohen ne deponi
11. Fraksioni 16-22 mm me ndihmen e shiritit nr 7 dergohen ne deponi
12. Fraksioni > 22 mm me ndihmen e shiritit nr 8 dergohet ne dozerin sekondar
13. Pas mbushjes se dozerit sekondar me material, ne menyre automatike fillon dozimi i materialit ne shiritin nr 9, e cila e dergon materialin ne gurethyesin konik
14. Nga gurethyesi konik materiali i thyer me ndihmen e shiritit nr 10 dergohen ne shiritin nr 2 dhe procesi per kete material perseritet

Produktet nga ky proces i seperimit jane fraksionet:

- I. Fraksionin 0-4 mm
- II. Fraksioni 4- 8 mm
- III. Fraksioni 8-16 mm
- IV. Fraksioni 16-22 mm

Keto fraksione do te perdoren kryesisht për tampon për agregat betoni, agregat asfalti dhe elemente të betonit (kubëzat dhe gypat e betonit), etj.

Uji i cili do te perdoret ne kete process i teri do te reciklohet, per kete planifikohet qe te ndertohen rezervaret per dekantimin e dheut nga uji. Nga rezervaret dheu i dekantuar do te largohet dhe do te kthehet perseri ne vendet e germuara.


MAkineria	Prodhuesi	Vendi i origjines	Lloi / Tipi	Kapaciteti / specifikacioni	Sasia
Luge Ngarkuese	OK 35	Gjermani	35	3 m3	1 cope
Eskavator	OK 6.5	Gjermani	6.5	1.2 m3	1 cope
Kamion	DAF	Suedi	350	20 m3	1 cope
1. Dozeri me dhanes	Aman	Gjermani	Statik	8 m3	1 cope
2. seperacioni primar	Aman	Gjermani	Statik	3 fraksione me larje, dimensionet 4.5*1.2 m	1 cope
3. gurethyesi me Nofulla	Ratzinger	Gjermani	Statik	22 Kw, hyrja 150*550 mm	1 cope
4. Laresja primare me spirale		Kosove	Statike	7.5 Kw	1 cope
5. seperacioni sekondar		Kosove	Statik	7.5 Kw, 5 fraksione,	1 cope
6. laresja sekondare me korpa		Kosove	Statik	4.0 Kw	1 cope
7. Dozeri per kthim		Kosove	Statik	22 m2, dimensionet 6.0*2.3 m	1 cope
8. Gurethyesi konik	WEIL	Gjermani	BS 702	20-40 m3, 45 KW	1 cope

Pershkrimi	Fraksionet	Gjatesia e	Gjeresia e	Fuqia e
Traka 1	Zalli natyror	14 m	1.0 m	7.5 Kw
Traka 2	Fraksioni > 25 mm	12 m	0.6 m	4.0 kw
Traka 3	Fraksioni 0-25 mm	18 m	0.8 m	7.5 Kw
Traka 4	Fraksioni 0-8 mm	6 m	0.5 m	4.0 Kw
Traka 5	Fraksioni 0-4 mm	20 m	0.6 m	7.5 Kw
Traka 6	Fraksioni 4-8 mm	16 m	0.5 m	7.5 Kw
Traka 7	Fraksioni 8-16 mm	16 m	0.5 m	7.5 Kw
Traka 8	Fraksioni 16-25 mm	12 m	0.5 m	4.0 Kw
Traka 9	Fraksioni > 25	12 m	0.5 m	5.5 Kw
Traka 10	Fraksioni i perzier	12 m	0.5 m	5.5 Kw

Pajimet në gurëthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari do të bëj ndërtimin e trafos dhe të rrjetit elektrik me mjete personale. Por për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike investitori do të pajiset edhe me një gjenerator për aktivizimin e pajimeve teknologjike, gjithashtu ne këte lokacion pronari planifikon të ndërtoj oficinën për mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese si dhe pajimeve prodhuese.

Ne vazhdim do e paraqesim skemen e procesit teknologjik te thermuseses me seperim:

Paraqitja skematike e procesit teknologjik te thermuseses me seperim:



5.0 Vlerësimi dhe Përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

5.1. Ndikimet në ajër

Aktiviteti i hulumtimit, shfrytëzimit, thermimit dhe seperimit të rërës kuarcore nuk shoqërohet me ndotje të theksuar të ajrit. Ndotja e ajrit ndodhë nga lirimi i pluhurit gjatë procesit të largimit shtresës së sipërme të dheut (sterilit), gjatë mihjes (gërmimit), gjate fazes se kryrjes se hulumtimeve(hapjes se kanaleve hulumtuese, shpimeve te cekta) gjatë ngarkimit, gjatë transportit dhe shkarkimit të zhavorrit dhe rërës kuarcore, lirimi i pluhurit gjatë manipulimit me makina ngarkuese dhe automjetet transportuese ne sipërfaqet operationale, dhe ne rrugët transportuese, gjate zhvillimit te procesit teknologjik te thermimit dhe seperimit te lendes se pare.

Ndotja nga automjetet transportuese, ndotje e cila megjithatë është më e ulët se ajo që shkaktohet në rrugët tjera me frekuentim më të shpeshtë.

Ndotësit janë kryesisht grimcat e mëdha të pluhurit të cilat lirohen gjatë aktiviteteve të cekura me larte, ngarkimit dhe transportit të lendes se pare gjerë te thërmuesja. Pluhurat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, kurse pluhurat me përbërje granulometrike të imta dhe përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lënda minerale, i bartë ajri për shkak të relievit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca ma të largëta.

Gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin e lendes se pare, ndikime negative në ajër ndodhin nga:

Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e thyerjes së masës, do të thotë te thërmuesja nofullore primare, thërmueset me traj sekondare. Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve ne të gjithë shiritat transportues si dhe ne sitat vibruese. Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërmuar. Pluhurat të cilët lirohen gjatë ngarkimit dhe transportimit të fraksioneve me automjetet transportuese.

Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të minierës dhe thërmueses me seperacion. Gazërat të cilat lirohen nga automjetet e ngarkimit dhe transportit

5.2. Ndikimet në tokë

Ndikimi negativ në tokë paraqitet nga deponimi i shtresës së sipërme të dheut (sterilit) e cila duhet të ruhet për mbushjen e hapësirës së shfrytëzuar.

Lokacioni i zgjedhur për depozitimin e djerrinës ka hapësirë të mjaftueshme për palosje të sasisë së masave të djerrinës të sipërsënuara.

Ndikime negative janë edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të detyrueshme të makinave ngarkuese dhe transportuese, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese.

Ndikime negative paraqiten nga deponia e cila nevojitet për deponimin e zhavorrit dhe rërës, nga mundësia e erozionit, rrëshqitja e rërës kuarcor gjatë periudhës së shfrytëzimit.

Ndikim negativ tjetër paraqitet me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat ngarkuese dhe transportuese, nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet operationale. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga makinat punuese gjatë riparimeve të detyrueshme, dhe furnizimit me derivate dhe gjatë ndërrimit të vajrave.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të proceseve teknologjike për hulumtimin, shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e lëndës së pare mund të shkaktohen:

- Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.
- Nga derivatet dhe vajrat të cilat krijohen në oficinën e riparimit të mjeteve ngarkuese dhe transportuese.
- Nga vajrat dhe lubrifikantët e ndryshëm që derdhen nga pajimet dhe stabilimentet prodhuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.
- Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese. Mbeturinat e ngurta

dhe të lëngëta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese

- Gjithashtu, në ndotjen e ujërave ndikojnë grimcat e ngurta, dhe pluhurat të cilat barten me anë të ujërave sipërfaqësore.
- Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, etj.

5.4. Ndikimet në Peizazh

Lokacioni ku do të kryhen aktivitetet e mihjes sipërfaqësore dhe thërmuesja me separacion me objektet përcjellëse, gjithnjë do të merrë pamjen e një vendi industrial. Gjatë fazës së shfrytëzimit normalisht, peizazhi pëson një degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do t'i kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt me gjendjen e mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensimin të shfrytëzimit të pasurive /resurseve natyrore.

Prandaj, duke pasur parasysh pozitën e lokacionit dhe atë që u cekë më lart, mendojmë se shfrytëzimi i zhavorrit dhe rërës kuarcore nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në peizazh.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vërejtë se ndikimet në florë dhe faunë .

Mirëpo, sipas gjendjes faktike në terren respektivisht në lokacionin e caktuar për hulumtimin, shfrytëzimin dhe seperimin e rërës kuarcore nuk kemi zhdukje të madhe të vegjetacionit përpos nga sipërfaqet operacionale.

Për shkak të proceseve teknologjike të cilat zhvillohen në mihjen sipërfaqësore dhe thërrmueseve me seperacion dhe në gjatësinë kohore të operimit flora tërësisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve minerare dhe prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndikime negative në popullatë do të ketë në aspektin e ndotjes së ajrit ndotjes së tokës, ujit, krijimit të zhurmës, rritjes së numrit të mjeteve transportuese në komunikacion, më aplikimin e masave që do të përshkruhen në këtë raport këto ndikime do të neglizhohen.

Zhvillimi i veprimtarisë hulumtuese, shfrytëzuese, thërrmuese dhe seperuese të lëndës së parë nga Kompania „Ranori” për këtë rajon ka një rënësi të veçantë për popullatën e këtij rejonit sepse do të bëjë punësimin e një numri të punëtorëve.

Nga faktet e lartë cekura mund të konkludojmë se në aspektin social dhe ekonomik kompania „Ranori” që veprimtarinë e vet e ka shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e zhavorrit dhe reres do të ketë ndikime pozitive në popullatë.

5.7. Zhurma

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve për hulumtimin, shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e reres, kryesisht nga makinat gjatë procesit të mihjes, ngarkimit, transportit, dhe nga proceset teknologjike për thërrmimin dhe seperimin e lëndës së parë.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Duke pasur parasysh largësinë e vendbanimeve zhurma për zonën e banuar do të jetë plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës rrallë punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Në vijim do të paraqesim një pasqyrë tabelore të nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db – niveli për pajisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Bazuar në aktivitetin e hulumtimit, ekspluatimit, seperimit dhe thërrmimit të lëndes se pare nga Kompania „Ranori” incidentet me ndikim ambiental në rajon nuk mund të ndodhin, sepse natyra e prodhimit është e tillë nuk përmban / përdor substanca të rrezikshme. Ndonjë incident me karakter lokal mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si: Gjatë germimit.

Gjatë përgatitjes së fushës per germim.

Gjatë punëve në etazhet punuese.

Gjatë proceseve tjera teknologjike në shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e lëndes se pare.

Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia plasjes së gypave hidraulik, mundësia e ndezjes).

Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të fraksioneve të prodhuara.

6.0 Marrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve

6.1. Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarrë këto masa: Gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet operationale ku do të bëhet mihja (germimi), ngarkimit dhe transportimi i rërës kuarcore, duhet vazhdimisht të spërkatet me ujë, posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.

Depoja ku do të deponohet rëra kuarcore, duhet të spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.

Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave mihëse, ngarkuese dhe automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

Gjithashtu, pjesa e rrugës së pa asfaltuar duhet kohë pas kohe të spërkatet me ujë. Kamionët të cilët bëjnë transportin e lendes se pare duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, për arsye që pluhuri gjatë transportit të mos shpërndahet nga ta dhe ne kohëra me temperatura të larta dhe me erëra të spërkatën me ujë. Duhet të jetë çdo herë në disponim autocisterna me ujë për spërkatje.

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania është e detyruar të bëj instalimin e sistemit të ujit për zvogëlimin e sasisë së pluhurit. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi (bunari) pronë e kompanisë, ose furnizim i ujit të nevojshëm me cisternë, me anë të pompës së ujit nëpër mjet gyp sjellësve sillet gjerë te gurëthyesi me seperacion. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të thërrmimit dhe seperimit duhet vendosur në tëra stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë në bunkerin (fortinën) pranues, në gurthyesen me nofulla, në gurthyeset me traj sekondare dhe terciare, në sitat vibruese (seperatorin), dhe në të gjithë shiritat transportues. Në sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në mënyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosën diznet të cilat e lëshojnë ujin në formë mjegulle e cila bënë ujitjen e masës, dhe në këtë mënyrë masa e cila do të thërrmohet dhe seperohet ujitet ashtu që nga masa nuk mundë të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet në sasi vetëm sa të bëj rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen në mjedis, kjo sasi varret nga lagështia e lendes se pare e cili thërrmohet dhe seperohet. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin, duhet që tërë shiritat transportues e posaçërisht shiritat transportues që transportojnë fraksionet e imta duhet të mbulohen dhe në vend rrjedhje të fraksioneve duhet të ndërtohen hinkat.

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit nëse me instalimet e sistemit të ujit dhe sistemin e depluhimit që është paraqitur në shemën teknologjike nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin, Kompania duhet të bëjë instalimin e sistemit të depluhimit me anë të filterve që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit.

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e lëndës së pare, përpos masave të lartë cekura duhet ndërmarr edhe këto masa: Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve për thërrmimin dhe seperimin e lëndës së pare, e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.

Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër .

Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen.

Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirim i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese dhe fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.

Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, në kohë të thata edhe të spërkatën me ujë.

Duhet të bëhet matja e emisioneve dhe misioneve të pluhurit gjatë punës në punishte dhe në territorin më të gjerë, duke iu përmbajtur të gjitha masave të cekura më lartë për mbrojtjen e ajrit, me qëllim të caktimit të sasisë së përbërjes së thërrmijave të pluhurit, dhe për të krahasuar vlerat e matura më vlerat kufitare të caktuara me ligj.

6.2. Masat për mbrojtjen e tokës

Me qëllim të ruajtjes së tokës nga ndikimet negative duhet ndërmarr këto masa:

Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen makinat mihëse, ngarkuese, thermuese - seperuese dhe automjetet transportuese. Duhet të merrën masat e nevojshme

për moslëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat mihëse, ngarkuese dhe automjetet transportuese.

Vaji i makinave mihëse, ngarkuese dhe automjeteve transportuese nuk duhet të ndërrohet në lokacionin ku behët shfrytëzimi i lendes së pare, mirëpo nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit për shkak të avarive në makinat mihëse dhe ngarkuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jolëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.

Ndërrimi i vajrave duhet të bëhet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.

Në kohëra kur ka të reshura atmosferike të mos punohet me makina, me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.

Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohet në lokacionin ku shfrytëzohet lenda e pare duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.

Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponinë regjionale .

Vajrat e ndërruara nga makinat ngarkuese dhe transportuese, duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe do t'u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.


Depoja eventuale ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thurret me mur statik dhe të mbulohet si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet, në të të vendoset sistemi i bartjes së ujërave gjerë në Seperator të vajrave

Kamionët të cilët bëjnë transportin e rërës duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes së rërës kuarcore që transportohet.

6.3. Masat për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e mihjes nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përqark mihjes

sipërfaqesore. Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga lokaliteti i minierës gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen pusët sedimentuese për sedimentimin e materieve të ngurta dhe separatori për pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate. Në mihjen sipërfaqësore gjithmonë duhet të ketë në disponim absorbues të vajrave dhe derivateve. Në lokalitetin e thërmueses me seperacion duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit dhe ujërave nga të reshurat atmosferike, duhet të bëhet kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga të gjitha sipërfaqet operationale të thërmueses me seperacion, nga sipërfaqet operationale të oficinës së mirëmbajtjes dhe kanalit të ndërrimit të vajrave, nga sipërfaqet e depos së vajrave dhe lubrifikanteve të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta. Përpos sistemit të gypave duhet të ndërtohet edhe sistemi i kanalit rreth e për qark minierës si dhe gurthyesit dhe sipërfaqeve operationale për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura gjërë në pusët sedimentuese. Pusët sedimentuese duhet të ndërtohen tri puse për sedimentimin e thërmijave të ngurta. Pas trajtimit në pusët sedimentuese uji orientohet për trajtim të mëtejshëm në separatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operationale, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e trajtuara në separator të lëshohen në gropën septike. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe separatori.



Ujërat e zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet ndërtuar e pastaj të lirohen ne recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Gropa septike duhet të ndërtohet në at mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe mostrim të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient.

Rekomandohet që të ndërtohet një rezervuar me qëllim të mbajtjes së ujërave të trajtuara, uji i trajtuar (pastruar) do të rikthehet në procesin teknologjik, kështu që do të mbyllet cikli i trajtimit dhe furnizimit me ujë industrial, dhe do të parandalohet shkarkimi i ujërave.

Do të ekzistojnë dy mundësi të shkarkimit të ujërave të trajtuara njëra drejt për drejt nga seperatori në recipient, tjetra mundësi prej seperatorit në rezervuar, prej nga do të shkarkohet në recipient nëse nuk nevojitet për procesin teknologjik, që shihet edhe nga shema teknologjike e trajtimit të ujërave të ndotura.

Duhet të bëhet kontrollimi i ujit ne recipient në pikat para shkarkimit të tij dhe pas shkarkimit të ujit, dhe ne vendin e shkarkimit të ujit ne pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR. Këto matje të bëhen katër herë në vit, apo në bazë të marrëveshjes me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe I frastruktues. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe seperatori.

6.4. Masat për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat për mbrojtje nga zhurma. Analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në bazë të vlerave të lejuara dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për hulumtimin, shfrytëzimin, thërrmimin dhe seperimin e lëndes se pare, mund të konkludojme se nuk ka ndikime të mëdha negative në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të thërrmueses me seperacion.

Në raste se zhurma e mjedisit nga matjet tejkalon ate të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas

rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimore kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në afërsi të sipërfaqeve shfrytëzuese.

Kompanisë „Ranori Sh.P.K” i epet urdhëresë që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Për mbrojtjen e botës shtazore Kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës ku do të kryhen operacionet teknologjike për shfrytëzimin e lendes se pare, të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit.

6.6. Masat për mbrojtjen nga rreziqet e aksidenteve mjedisore

Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë shfrytëzimit të lendes se pare duhet ndërrmar këto masa: Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Për pengimin nga erozioni duhet që pjerrtësinë dhe madhësinë e shkallës punuese të e mbajmë sipas përcaktimit në bazë të projektit për shfrytëzimin e rërës kuarcore. Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri. Duhet e tërë fusha eksploatuese të thuret me tel gjembor.

Të mirën të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat mihëse, ngarkuese dhe automjeteve transportuese.

Duhet të kenë në dosponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet liqenit artificial të krijuar gjatë nxjerrjes së rërës kuarcore si dhe puseve sedimentuese.

Këto hapësira duhet të rrethohen me tel gjembor me qëllim që të evitohen rreziqet eventuale të mundshme, për njerëzit dhe botën shtazore.

Duhet të tëra sipërfaqet operationale dhe pusët sedimentuese të thurën me tel gjembor.

Automjetet transportuese të mos zhvillojnë shpejtësi më të madhe se dyzet km/orë, brenda vendbanimeve.

Të merrën të gjitha masat e sigurisë komform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7.0 Programi i monitorimit

Ndikimet direkte nga aktiviteti i realizimit të proceseve teknologjike për hulumtimin, shfrytëzimin dhe themimin me seperim të rërës kuarcore, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues për degradimet e tokës, kualitetin e ajrit dhe ujit. Duhet të bëhet matja e kualitetit të ajrit (matja e imisionit) gjatë punës maksimale të pajimeve. Matja duhet bërë të shtëpitë më të afërta. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, duhet të krahasimin e rezultateve me rezultatet e më hershme dhe vlerat e caktuara me ligjet në fuqi. Rezultatet të raportohen në Ministri të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura sipas kërkesës së tyre.

Detyrat e monitorimit të mjedisit përcaktohen si më poshtë:

- Kontrollimi i plotësisë dhe cilësisë së detyrave inxhinierike të projektit
- Përcaktimi i nivelit të ndikimit në mjedis
- Kontrolli i përputhjes së parametrave fillestare të projektit me situatën aktuale
- Hartimi i propozimeve për të ofruar "siguri ekologjike" aty ku mospërputhja ndodh në mes të rezultateve të vëzhguara dhe ndikimeve të parashikuara.

Kontraktuesi do të zhvillojë masa që kanë për qëllim parandalimin ose pastrimin në lidhje me çdo aktivitet ndotës që nuk është paraparë në projekt. Gjatë periudhës së hulumtimit, shfrytëzimit dhe operimit, Kontraktuesi ose organizatat e rekrutuara nga Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për monitorimin.

Nëse është e nevojshme, do të përfshihen ekspertë të pavarur.

Monitorimi do të përfshijë:

- Kontrollimin e plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të projektimit të rregulloreve të miratuara në fazat e hershme të projektimit duke përfshirë masat që synojnë të përjashtojnë ose minimizojnë ndikimet, kompensimin, objektet për mbrojtjen e mjedisit dhe aktivitetet
- Përfshirja e masave, në projekt duke u shpjeguar punëtorëve të Kontraktuesit rregulloret për mbrojtjen e mjedisit dhe zgjidhje të problemeve së bashku me trajnimin e punonjësve nëse është e nevojshme
- Mbikëqyrja e kompensimit dhe pagesat e tyre, të parashikuara në projekt.
- Mbikëqyrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për themimin dhe seperimin e zhavorrit dhe reres kuarcore.
- Monitorimi i respektimit të rregulloreve, dokumenteve standarde, kushteve teknike dhe kërkesave të projektit nga Investitori

Kontrolli i performancës së punëve të rikultivimit:

- Ekzaminimi i efikasitetit të masave të parashikuara të projektit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për themimin dhe seperimin e zhavorrit dhe reres kuarcore dhe përditësimi i tyre, nëse është e nevojshme.
- Mbikëqyrja pas përfundimit të aktivitetit minerar të sistemit për mbrojtjen e mjedisit

Investitori do të jetë përgjegjës për monitorimin pas përfundimit të aktivitetit minerar dhe procesit teknologjik për themimin dhe seperimin e lëndës së parë derisa të jetësohet projekti ekologjik.

8.0 Raportimi

Do të kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e Kompanisë „Ranori” së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do t'i paraqesin të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ifrastruktures dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9.0 Marja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të aktiviteteve punuese

9.1. Objektivat e rikultivimit

Trajtimi i rikultivimit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të mbrojtjes dhe regjenerimit të mjedisit, duhet parë si një prioritet të rëndësishëm edhe në këtë regjion ku zhvillohet veprimtaria e hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për thermimin dhe seperimin e reres kuarcore.

Nga proceset teknologjike të hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për thermimin dhe seperimin e reres kuarcore do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim.

Substrate me përmbërës të rërës kuarcore, që patjetër duhet t'i nënshtrohen rehabilitimit gjerë në masën e përmirësimit të pjesërishëm të vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tij me ate të rrethit ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim bujqësor dhe ate për plantazhe të pemishteve .

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshinë rivitalizimin në tërësi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit - i cili nënkupton që pas përfundimit të punimeve të hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për thermimin dhe seperimin e reres kuarcore, sipërfaqeve të degraduara, prapë t'u kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës – planifikohet që toka në lokalitet të rikultivohet duke ju përshtatur gjendjes së përafërt me ate të mjedisit rrethues. Rikultivimi është i lidhur me aktivitet minerare, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e mihjes sipërfaqësore të mbyllur.

Duhet të bëhet mbushja e hapësirës së krijuar nga hulumtimi, shfrytëzimi dhe procesi teknologjik për thermimin dhe seperimin e reres kuarcore, për mbushjen e kësaj hapësire dhe kthimin e tyre në gjendje të përafërt me mjedisin rrethues dhe në ngastra që do të jenë të përshtatshme për kultivimin e të lashtave bujqësore. Pronari i kompanisë „Ranori” është i obliguar, që parashihet edhe me kontratë për

marrjen e ngastrës në shfrytëzim, që pas përfundimit të aktiviteteve të hulumtimit, shfrytëzimit dhe procesit teknologjik për themelimin dhe separimin e rërës kuarcore të bëjë rikultivimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara. Nga proceset për shfrytëzimin e rërës kuarcore është krijuar një sipërfaqe e thelluar (liqe artificial kur të ketë të reshura atmosferike), e cila duhet të mbushet dhe përgatitet për rikultivim. Rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara duhet të kryhet edhe gjatë shfrytëzimit të rërës kuarcore në kombinim të procesit të shfrytëzimit dhe mbushjes në të njëjtën kohë të sipërfaqeve të shfrytëzuara. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të shfrytëzuara përfshinë rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që gjatë procesit të shfrytëzimit të rërës kuarcore dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, sipërfaqeve të degraduara, prapë t'u kthehet funksioni i sajë primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së thërmueses me separacion e kjo varret nga rezervat e lëndës së pare në mihjen sipërfaqësore. Pas këtij afati pajimet e thërmueses me separacion duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdisë së Kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale.

Për të qenë rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit:

- Rikultivimi teknik.
- Rikultivimi agroteknik dhe
- Rikultivimi biologjik.

Me **rikultivimin teknik** do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret për nevoja tjera si psh. për mbjelljen e fidanëve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, apo mbjelljen me të lashta periodike bujqësore.

Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut gjerë në 50cm, dhe do të përdoret dheu i cili është larguar nga shtresa e sipërme e sipërfaqeve të shfrytëzuara i cili është deponuar në afërsi të ngastrave nga të cilat është eksploatuar lenda e pare.

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e **rikultivimit agroteknik** e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike.

Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Për të llogaritur numërin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në mes fidaneve.

$$N_f = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve. Në pjesët ku do të bëhet mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa më kompakte.

Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hidhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë.

Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanët duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse në momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara.

Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjile me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje.






Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasit optimale të lagështisë, kështu në pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj.

Qëllimi afatgjatë i **rikultivimit biologjik** është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha

elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësor, dhe në silvikulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin ku është bërë hulumtimi, shfrytëzimi dhe themimi – seperi i rres të mbillet me të lashta periodike dhe të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues apo me pemë fryt dhënëse si që u cek në pasuset e më sipërme. Rikultivimi i ngastrave të shfrytëzuara do të kryhet në marrëveshje dhe mbikëqyrje të inspektorëve të pushtetit lokal dhe inspektorëve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përgatitja dhe mbjellja e fidaneve shihet në figurat e më poshtme.



10.0 Kontrolli i emisioneve pas shfrytëzimit dhe thërrmimit me seperim

Me përfundimin e aktivitetit minerarë në minierë për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe aktiviteteve teknologjike në thërrmueset me seperacion, respektivisht pas përfundimit të jetës së minierës dhe rehabilitimit të ngastrave për qëllime tjera, nuk është e nevojshme dhe nuk parashihet monitorimi i ajrit, ujit dhe tokës apo ndikimet tjera në mjedis për shkak të shfrytëzimit përfundimtarë të minierës. Kompania shfrytëzuese, ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar për një kohë të caktuar.

11.0 Konsultimi me publikun

Konsultimi me publikun ka për qëllim informimin e publikut, vendimmarrësve, investitorëve, dhe palëve të tjera të interesuara mbi punimet dhe aktivitetet që do të kryhen për hulumtimin, shfrytëzimin, themimin dhe seperimin e reres në këtë lokalitet. Në këtë informacion do të jepen në mënyrë të përmblodhur ndikimet e mundshme mjedisore e sociale dhe masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative

Konsultimi synon nxitjen e komunitetit, vendimmarrësve dhe palëve të tjera të interesuara për dhënien e opinioneve të tyre mbi efektet e projektit, masat zbutëse, ide për venien më të mirë në efikasitet të planeve të zhvillimit të mëtejshëm të zonës.

Për këtë qëllim, do të organizohet një debat publik me banorët e zonës që janë të atakuar derjtpërsdrejti, përkatësisht fshatrat Klodernicë, Izbicë, Leçinë, Runik, me zyrtarët e Komunës së Skenderajit si dhe palet tjera të interesuara.

Njoftimi për debat publik do të bëhet përmes shpalljes në Gazetat zyrtare të Kosovës, në tabelat e shpalljes së informacioneve në Kuvendin Komunal të Skenderajit dhe në Web faqen e Komunes së Skenderajit.

11.0 Kostoja e parashikuar e Investimeve

Nr	Makineria	Prodhesi	Vendi i origjines	Lloi / Tipi	Sasia	Vlera
1	Luge Ngarkuese	OK 35	Gjermani	35	1	32,500.00 €
2	Eskavator	OK 6.5	Gjermani	6.5	1	18,500.00 €
3	Kamion	DAF	Suedi	350	1	13,250.00 €
4	Dozeri me dhanes	Aman	Gjermani	Statik	1	2,500.00 €
5	seperacioni primar	Aman	Gjermani	Statik	1	12,500.00 €
6	gurethyesi me Nofulla	Ratzinger	Gjermani	Statik	1	6,000.00 €
7	Laresja primare me spirale		Kosove	Statik	1	8,500.00 €
8	seperacioni sekondar		Kosove	Statik	1	18,500.00 €
9	laresja sekondare me korpa		Kosove	Statik	1	6,500.00 €
10	Dozeri per kthim		Kosove	Statik	1	5,500.00 €
11	Gurethyesi konik	WEIL	Gjermani	BS 702	1	40,000.00 €
12	Shirita transportues		Kosove	Statik	10	18,250.00 €
TOTAL						182,500.00 €

12.OPËRFUNDIME

Ndikimi ne mjedis nga zhvillimi i aktiviteteve per hulumtimin, shfrytezimin, thermimin dhe seperimin e reres kuarcore ne kete lokalitet, do të jetë në nivelin e vlerave të rekomanduara nga Ligji për Mbrojtjen në Mjedis, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe ligjet e aktet tjera nënligjore relevante për mjedis. Ndikimet në tokë, ujë dhe në ajër rregullisht duhet të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohet në fund të çdo viti kalendarik .

Pas punimit të këtij raporti, mund të konkludohet se hulumtimin, shfrytezimin, thermimin dhe seperimin e reres kuarcore ne lokalitetin Klodernice, komuna e Skenderajit nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve. Gjithashtu, ndikimet në tokë, ujë, ajër, peizazh dhe pamjen vizuale, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatojmë se ato mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm, ose edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara. Poashtu, është paraparë që paralel me shfrytëzimin e zhavorrit dhe rërës kuarcore, të bëhet edhe rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara aty ku lejojnë mundësitë e operacioneve teknologjike të shfrytëzimit.

Mendojmë, se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues dhënien e mendimit për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës të Fatmir Imerit, Drejtor menaxhues i Kompanisë „Ranori” Sh.P.K,Komuna Skenderaj, për hulumtimin, shfrytëzimin, thermimin dhe seperimin e reres kuarcore në lokalitetin Klodernicë, Komuna e Skenderajit.